



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 prill 2024  
Nr. ref.: MM 2424/24

**MENDIM MOSPAJTUES**  
i gjyqtarit Enver Peci të cilit i është bashkuar gjyqtari Jeton Bytyqi

në

**rastin nr. KI274/23**

**Parashtrues**

**Naser Husaj**

**Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Pml. nr. 516/2023] të 8 nëntorit  
2023 të Gjykatës Supreme**

E respektojme vendimin e Shumicës së Gjyqtarëve (në tekstin e mëtejme: Shumica) të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Megjithatë, gjithnjë me respekt, kemi votuar kundër papranueshmërisë së kërkesës dhe konsiderojmë se në çështjen konkrete kërkesa është e pranueshme dhe se ka pasur shkelje të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ). Prandaj, për arsytet që do të elaborohen në vijim paraqesim këtë Mendim mospajtuës bazuar në rregullin 56 (Mendimet mospajtuës) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

**Fushëveprimi i kërkesës**

- Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Pml. nr. 516/2023] të 8 nëntorit 2023 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në ndërlidhje me Aktgjykimin [PA1. nr. 163/2023] e 27 prillit 2023 të Gjykatës së Apelit, dhe Aktgjykimin [P.nr.646/17] e 17 marsit 2022 të Gjykatës Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
- Parashtruesi i kërkesës konsideron se me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Supreme të Kosovës i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
- Shumica vendosi ta deklarojë kërkesën të papranueshme, si qartazi të pabazuar.

## **Faktet e rastit dhe pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

4. Faktet e rastit, ashtu siç janë të reflektuara edhe në Aktvendimin e Papranueshmërisë në rastin KI274/23, ndërlidhen me veprën penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 269 paragrafi 2 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kodi i Përkohshëm Penal), e cila dyshohej se ishte kryer nga parashtruesi i kërkesës i cili përmes kontratës së shitblerjes të 21 dhjetorit 2011, të vërtetuar më 26 korrik 2012, duke e keqpërdorur një autorizim të lëshuar më parë nga i dëmtuari M.M., përkritazi me një parcele në afërsi të Hotelit “Onix” në Banjë të Pejës, me qëllim të përfitimit për vetën apo personin tjetër dhe pa dijeninë e pronarit - të dëmtuarit M.M., parcelën në fjalë ia kishte shitur të birit të tij.
5. Më 17 mars 2022, Gjykata Themelore, me Aktgjykimin [P. nr. 646/17], kishte shpallur fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën e lartcekur penale. Parashtruesi i kërkesës kundër këtij Aktgjykimi kishte parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila me Aktgjykimin [PA1. nr. 844/22] e 4 korrikut 2022 e refuzoi si të pa bazuar ankesën e parashtruesit dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
6. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, me ç’rast kjo e fundit përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 440/2022] të 27 dhjetorit 2022 e miratoi kërkesën e parashtruesit dhe e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe rastin e ktheu në procedure të rigjykitimit.
7. Më 27 prill 2023, Gjykata e Apelit në procedurën e rivendosjes, me Aktgjykimin [PA1. nr. 163/2023], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore. Kundër këtij Aktgjykimi, parashtruesi i kërkesës përsëri parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Gjykatën Supreme duke pretenduar, ndër të tjera, se çështja penale është parashkruar, pasi ka kaluar afati absolut për ndjekjen e kësaj vepre penale prej dhjetë (10) vite, nga kryerja e veprës penale më 26 korrik 2012, deri në dënimin e tij nga Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 163/2023] të 27 prill 2023.
8. Më 8 nëntor 2023, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin [Pml. nr. 516/2023], e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit me arsyetim se pretendimi për parashkrim absolut nuk është i bazuar, pasi me rastin e dënimit të parashtruesit të kërkesës nga Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 844/22] të 4 korrikut 2022, nuk kishte kaluar afati i parashkrimit prej dhjetë (10) viteve, pavarësisht që ky Aktgjykim i Gjykatës së Apelit ishte anuluar nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 440/2022] të 27 dhjetorit 2022, dhe rasti ishte kthyer në rivendosje.

## **Thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës**

9. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e neneve 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [ Mbrojtja Gjqësore e të Drejtave dhe 55 [Kufizimi i të Drejtës dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës në ndërlidhje me paragrafin 1 të nenit 6 [E Drejta për një proces të rregullt]] të KEDNJ-së.
10. Parashtruesi i kërkesës argumenton se para Gjykatës shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës pasi që Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë gabuar kur nuk kanë konstatuar se vepra penale që i vihet në barrë është subjekt i parashkrimit penal absolut. Kjo pasi vepra penale është parashkruar më 26 korrik 2022, duke pasur parasysh që vepra penale është kryer më 26 korrik 2012, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, pasi rasti

është rikthyer në rigjykim nga Gjykata Supreme, është nxjerr më 27 prill 2023, prandaj, Gjykata e Apelit ka vendos 9 muaj pas parashkrimit veprës penale.

### Vërejtje preliminare

11. Siç u theksua më lart, Shumica ka konstatuar se vendimet e kontestuara nuk janë nxjerrë në shkelje të pretenduara nga parashtruesi i kërkesës të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejta të Njeriut, pasi Gjykata Supreme ka dhënë arsye të mjaftueshme sa i përket pretendimeve të parashtruesit për parashkrimin e veprës penale.
12. Prandaj, Shumica konkludoi se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç garantohen me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, janë pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” dhe duhet të refuzohen qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç specifikohet në rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.
13. Me respekt ndaj Shumicës, nuk mund të pajtohemi me konstatimet e lartcekura, pasi konsiderojmë se këto konstatime nuk janë në pajtueshmëri me (i) nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës; si dhe (ii) praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), bazuar në të cilën, sipas nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, Gjykata është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
14. Në këtë kontekst, pavarësisht që parashtruesi nuk ka pretenduar shkelje të nenit 7 të KEDNJ dhe nenit 33 të Kushtetutës, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, kjo e fundit është përgjegjëse për karakterizimin e çështjeve kushtetuese që mund të përmbajë rasti konkret dhe se mund të shqyrtojë ankesat bazuar në dispozita kushtetuese që palët nuk i kanë kërkuar shprehimisht (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës: KI56/18, parashtrues: *Ahmet Frangu*, Aktgjykimi i datës 22 korrik 2020, paragrafi 81).

### Parimet e vendosura nga GJEDNJ përkitazi me parashkrimin e veprës penale

15. GJEDNJ ka theksuar se neni 7 i KEDNJ-së, përmban, ndër të tjera, parimin se vetëm ligji mund të përcaktojë veprën penale dhe dënimin (*nullum crimen, nulla poena sine lege*). Përderisa i njëjti e ndalon veçanërisht zgjerimin e fushëveprimit të veprave ekzistuese penale përkitazi me aktin që nuk kanë qenë paraprakisht të përcaktuara si vepra penale, i njëjti gjithashtu përcakton parimet që e drejta penale nuk mund të zgjerohet në dëm të të akuzuarit, për shembull përmes analogjisë. Bazuar në këto parime, sipas GJEDNJ-së, kjo e fundit duhet të vlerësojë nëse në kohën kur një i akuzuara ka kryer veprën që ka qar në ndjekjen dhe dënimin e tij, duhet të ketë qenë një normë ligjore që e ka bërë aktin e dënueshëm, dhe që dënimi i dhënë nuk i ka kaluar kufizimet e përcaktuara me atë normë. (Shih rastin e GJEDNJ-së *Coëme dhe të tjerët kundër Belgjikës*, nr. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, Aktgjykim i 22 qershorit 2000, paragrafi 145).
16. Në këtë kontekst, sipas GJEDNJ-së, këto kufizime mund të përkufizohen si të drejta ligjore të kryesit që të mos ndiqet apo dënohet pas kalimit të një periudhe kohore nga koha e kryerjes së veprës. Prandaj, sipas GJEDNJ-së, afatet e parashkrimit, të cilat janë karakteristikë e përbashkët sistemeve juridike të shteteve anëtare, i shërbejnë disa qëllimeve, përfshirë sigurinë juridike (shih rastet e GJEDNJ-së *Coëme dhe të tjerët*,

cituar më lart, paragrafi 146; dhe *Antia dhe Khupenia kundër Gjeorgjisë*, nr. 7523/10, Aktgjykim i 18 qershorit 2020, paragrafi 39).

17. Për më tepër, bazuar në Opinionin Këshillues të GJEDNJ-së të kërkuar nga Gjykata e Kasacionit të Armenisë, lidhur me aplikimin e parashkrimit përkitazi me ndjekjen, dënimin dhe ndëshkimin sa i përket akteve që përbëjnë, në përmbajte, akte të torturës, ka theksuar që kur vepra penale, sipas legjislacionit vendor ka qenë subjekt i parashkrimit në kuptim që ka përjashtuar përgjegjësinë penale, neni 7 i KEDNJ-së e përjashton rifillimin e ndjekjes sa i përket asaj vepre në mungesë të një baze ligjore. Sipas Opinionit të lartcekur të GJEDNJ-së, nëse do të ishte ndryshe, kjo do të nënkuptonte *“zbatimit retrospektiv të së drejtës penale në dëm të të akuzuarit”* (Shih Opinionin Këshillues të GJEDNJ-së të kërkuar nga Gjykata e Kasacionit të Armenisë lidhur me aplikimin e parashkrimit përkitazi me ndjekjen, dënimin dhe ndëshkimin sa i përket akteve që përbëjnë, në përmbajte, akte të torturës, P16-2021-001, të 26 prillit 2022).
18. Rrjedhimisht, konsiderojmë se bazuar në atë që u theksua më lart, rezulton se e drejta për të mos u gjykuar pa ligj, bazuar në nenin 7 të KEDNJ-së, parimet e së cilës janë po ashtu të përfshira edhe në nenin 33 të Kushtetutës, përjashton përgjegjësinë penale, në rastet kur afati i parashkrimit i përcaktuar me ligj ka kaluar.

#### **Ndjekja penale dhe parashkrimi sipas Kodit Penal të Kosovës dhe zbatimi i këtyre dispozitave në rastin konkret**

19. Ashtu siç u theksua edhe më lart, parashkrimi konsiston në atë se për shkak të kalimit të afatit të paraparë me ligj nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe personit nuk mundë t'i shqiptohet dënim për veprën e kryer penale. Thënë këtë, në çdo fazë të procedurës penale gjykatat dhe organet tjera të ndjekjes janë të detyruara edhe sipas detyrës zyrtare të kujdesen, ta marrin parasysht dhe ta zbatojnë parashkrimin në të gjitha rastet kur skadojnë afatet e tilla kohore.
20. Në këtë kontekst, neni 90 (Parashkrimi i Ndjekjes Penale) i Kodi të Përkohshëm Penal, (i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale) ka rregulluar çështjen e parashkrimit relativ të ndjekjes penale varësisht nga vepra e kryer penale dhe dënimi maksimale që parashihet për at veprë penale. Në këtë kontekst, neni 90 i Kodit të Përkohshëm Penal përcakton se, përveç nëse shprehimisht parashihet ndryshe atë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar afatet e mëposhtme, ndër të tjera:  
  
*“[...]*  
*3.dhjetë (10) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se pesë vjet burgim;*  
*4.pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre vjet burgim;*  
*[...]”*
21. Ndërsa neni 91 (Fillimi dhe Ndërprerja e Parashkrimit të Ndjekjes Penale) i Kodi i Përkohshëm Penal, në gjashtë (6) paragrafë specifikon fillimin e afatit të parashkrimit, që si rregull është dita kur është kryer vepra penale, pastaj përjashtimet, se kur nuk rrjedh koha e parashkrimit dhe rastet kur nuk ndërprehet parashkrimi. Në këtë kontekst, paragrafit 6 i nenit 91 të Kodi të Përkohshëm Penal, që ndërlidhet me rastin konkret, në mënyrë të qartë përcakton se *“Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të*

*ketë kaluar dyfishi i kohës së parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)*". Prandaj, në terminologjinë juridiko – penale kjo quhet parashkrim absolut.

22. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh që vepra penale e përcaktuar në nenin 269 (Keqpërdorimi i besimit) të Kodit të Përkohshëm Penal ishte e dënueshme me dënim deri në pesë (5) vite, rezultoi se në këtë rast parashkrimi absolut do të arrihej me kalimin e afatit prej dhjetë (10) viteve që është dyfishi i afatit të parashkrimit të përcaktuar me nenin 91 të Kodit të Përkohshëm Penal.
23. Në ndërlidhje me rastin konkret, nga shkresat e lëndës, nuk është kontestuese se:
  - (i) vepra penale për të cilën parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor ishte kryer më 26 korrik 2012;
  - (ii) përmes Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të 17 marsit 2022, parashtruesi i kërkesës ishte shpallur fajtor për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të besimit nga neni 269, paragrafi 2 i Kodit të Përkohshëm Penal, për cilën veprë penale ishte paraparë dënimi maksimal prej 5 (pesë) viteve;
  - (iii) Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 844/22] të 4 korrikut 2022, ankesën e parashtruesit e kishte refuzuar si të pabazuar dhe kishte vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës së shkallës së parë, gjë që rezultoi se me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit të lartcekura, pra Aktgjykimit të parë të Gjykatës së Apelit, ende nuk kishte kaluar afati i parashkrimit.
24. Megjithatë, më 27 dhjetor 2022, Gjykata Supreme, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 440/2022], kishte miratuar kërkesën në fjalë dhe kishte anuluar Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe çështjen e kishte kthyer në rivendosje dhe rigjykim në Gjykatën e Apelit.
25. Përkitazi me këtë, i referohemi dispozitave të nenit 394 (Kufijtë e shqyrtimit të ankesës nga gjykata e apelit) të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale, që ishte zbatuar në rastin konkret (në tekstin e mëtejshëm: Kodi i Procedurës Penale) që kanë përcaktuar kufijtë e shqyrtimit të ankesës nga Gjykata e Apelit, duke obliguar Gjykatën e Apelit që edhe sipas detyrës zyrtare të shqyrtojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, nëse ekzistojnë shkeljet esenciale e dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 të këtij Kodi ose nëse është shkelur ligji penal në dëm të të akuzuarit.
26. Ndërsa, neni 385 (Shkelja e ligjit penal) i Kodit të Procedurës penale në paragrafin 1.3 përcakton se shkelja e ligjit penal ekziston kur *“ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë apo faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë”*.
27. Për më tepër, i referohemi nenin 440 (Anulimi i aktgjykimit të formës së prerë të gjykatës themelore) të Kodit të Procedurës Penale, përkatësisht paragrafit 1, që përcakton se *“Në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, procedura merr për bazë aktakuzën e mëparshme [...]”*, ndërsa bazuar në paragrafin 2 të nenin 440 të Kodit të Procedurës Penale *“Gjykata detyrohet të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale dhe të shqyrtojë të gjitha çështjet për të cilat e ka paralajmëruar Gjykata Supreme e Kosovës”*. Kjo dispozitë ligjore zbatohet edhe për gjykatën themelore edhe për Gjykatën e Apelit nga se nuk i përket vetëm Gjykatës Themelore të vlerësojë parashkrimin por edhe Gjykatës së Apelit.

28. Bazuar në dispozitat e lartcekura, sipas mendimit tonë, çështja e parashkrimit të ndjekjes penale ishte aktualizuar sërish në momentin kur Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin me të cilin e anuloi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit [PA1. nr. 844/22] të 4 korrikut 2022, pasi që në atë moment çështja ishte kthyer në rivendosje dhe Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [P. nr. 646/17] i 17 marsit 2022 nuk ishte më i formës së prerë, dhe si pasojë Gjykata e Apelit duhej rivendosur për të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të kërkesës sipas gjetjeve të Aktgjykimit [Pml. nr. 440/2022] të 27 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme.
29. Kjo pasi, vendimi i formës së prerë, që ka shërbyer si bazë për të konstatuar se nuk ka kaluar afati absolut i parashkrimit, tani më nuk ka ekzistuar. Prandaj, për të gjitha veprimet procedurale dhe pretendimet e ushtruesit të ankesës, përfshirë çështjen e parashkrimit, do të duhej vlerësuar duke pasur parasysh se vendimi i Gjykatës Themelore [P. nr. 646/17] i 17 marsit 2022 ishte në pritje të vendimmarrjes nga Gjykata e Apelit për herën e dytë.
30. Thënë këtë, Gjykata e Apelit, siç shihet nga shkresat e lëndës, më 27 prill 2023, në procedurën e rigjyimit, përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 163/2023], e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndërsa e vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [P. nr. 646/17] e 17 marsit 2022. Prandaj, konsiderojmë se për qëllim të vlerësimit se kur ishte dënuar parashtruesi i kërkesës në ndërlidhje me parashkrimin, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte bërë i formës së prerë më 27 prill 2023, me nxjerrjen e Aktgjykimit [PA1. nr. 163/2023] të Gjykatës së Apelit, e jo me Aktgjykimin paraprak të Gjykatës së Apelit të 24 korrikut 2022.
31. Prandaj, konsiderojmë se bazuar në kornizën e lartcekur ligjore, Gjykata e Apelit ka qenë e obliguar që përveç pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, edhe sipas detyrës zyrtare, të vlerësojë shkeljen e ligjit penal sipas nenit 385 të Kodit të Procedurës Penale, e cila dispozitë ligjore në paragrafin 1, nënparagrafin 1.3, ka përcaktuar qartë se shkelja ligjit penal ekziston kur ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale, e sidomos nëse ndjekja penale është parashkruar.
32. Prandaj, prej datës së kryerjes së veprës penale, më 26 korrik 2012 e deri më 27 prill 2023, kur ishte nxjerr Aktgjykimi [PA1. nr. 163/2023] i Gjykatës së Apelit, me ç'rast Aktgjykimi i Gjykatës Themelore ishte bërë i formës së prerë, kishin kaluar 10 (dhjetë) vite e 9 (nëntë) muaj. Si pasojë, në rastin e parashtruesit përkitazi me veprën penale për të cilën akuzohej, kishte kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut) prej dhjetë (10) viteve, i përcaktuar me Kodin e Përkohshëm Penal.
33. Fakti që në Aktgjykimin e parë të 24 korrikut 2022, Gjykata e Apelit ka vendosur para skadimit të parashkrimit absolut në shkallën e parë nuk e ka liruar Gjykatën e Apelit, që me rastin e anulimit të Aktgjykimit saj nga Gjykata Supreme, sërish të vlerësojë çështjen e parashkrimit. Kjo pasi dispozitat e Kodit të Procedurës Penale e obligojnë Gjykatën e Apelit që sërish të vlerësojë shkeljet e ligjit penal që u specifikuan më lart, përkatësisht çështjen e parashkrimit të përcaktuar në paragrafin 1.3 të nenit 385 të Kodit të Procedurës Penale.
34. Në të kundërtën, nëse do të vlente parimi se parashkrimi i ndjekjes nuk ka arritur nëse njëherë gjatë procedurës, Aktgjykimi i shkallën së parë bëhet i formës së prerë, pavarësisht që Gjykata Supreme e anulon të njëjtin, kjo do të krijonte pasiguri juridike për kryesit të veprës penale në kundërshtim me parimi qenësor të legjislacionit penal se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, siç rezulton edhe nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së.

35. Për më tepër, edhe Gjykata Supreme me rastin e shqyrtimit të dytë të kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, më 8 nëntorit 2023, ka pasur për obligim të merr parasysh çështjen e parashkrimit absolut bazuar në praktikën gjyqësor e GJEDNJ-së e sqaruar më lart, dhe nenin 437 (Refuzimi i kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë) të Kodit të Procedurës Penale, bazuar në të cilin kërkohet që Gjykata Supreme të vërtetojë se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilin pretendon paraqitësi i kërkesës, gjë që në rastin konkret, ky nuk ishte rasti.
36. Prandaj, rezulton se Gjykata Supreme, në arsyetimin e saj përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 516/2023] të 8 nëntorit 2023, kishte vlerësuar se vepra penale nuk është parashkruar, bazuar në vendimin e parë të Gjykatës së Apelit të 24 korrik 2022, ndërsa nuk jep asnjë sqarim përkritazi me atë se ky Aktgjykim ishte anuluar nga vet Gjykata Supreme dhe çështja ishte kthyer në rivendosje në Gjykatën e Apelit. Prandaj, e njëjta nuk kishte korrigjuar lëshimet e Gjykatës së Apelit përkritazi me çështjen e parashkrimit absolut të veprës penale për të cilën akuzohej parashtruesi i kërkesës.
37. Si pasojë, konsiderojmë se duke mos shqyrtuar pretendimin e parashtruesit të kërkesës për parashkrim të veprës penale për të cilën akuzohej, përkatësisht faktin se nga kryerja e veprës penale më 26 korrik 2012 deri në vendimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit, përmes Aktgjykimit të 27 prillit 2023, kishin kaluar më tepër se dhjetë (10) vite, dhe si pasojë kishte arritur parashkrimi absolut i veprës penale, pasi kishte kaluar më shumë se dyfishi i dënimit të përcaktuar për veprën penale të keqpërdorimit të besimit për të cilën akuzohej parashtruesi i kërkesës, Gjykata Supreme ka cenuar nenin 7 (Nuk ka dënim pa ligj) të KEDNJ-së dhe nenin 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës.

Dorëzuan me respekt,

Gjyqtari Enver Peci



Gjyqtari Jeton Bytyqi

